

**VENDIM**  
**Nr. 568, datë 24.6.2015**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME  
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE  
SHOQËRISË “LUBIMA” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “KODRA, Qafa E  
BUALLIT”, NË BASHKINË BULQIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Lubima” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Kodra, Qafa e Buallit”, shesh, truall i lirë, në administrim të Bashkisë Bulqizë, me sipërfaqe të përgjithshme 12 200 (dymbëdhjetë mijë e dyqind) m<sup>2</sup>.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**